

Trajtimi i mastitit nëpërmjet homeopatisë?

Mag. Gerhard Gumhalter, mjek veteriner nga Austria



Mastiti mund të zbulohet herët me anë të testit të Schalm-it

Mastiti është një inflamacion i gjendrës së qumështit. Kjo sëmundje haset në dy forma: si inflamacion subklinik (i fshehur), që zhvillohet pa asnjë shenjë të dukshmetë sëmundjes ose si inflamacion klinik (i dukshëm) që mund të diagnostikohet lehtë përmes shenjave si: enjtje ose forcim i zonës së prekur si dhe ndryshimi në prodhim dhe në cilësinë e qumështit.

Shkaqet për inflamacionin e gjirit mund të jenë p.sh. bakteret dhe toksinat, faktorë mekanikë si p.sh. goditje, përplasje, presion si dhe kushte ekstreme atmosferike si ftohtësia dhe temperatura e lartë. Shkaktarët e inflamacionit akut të gjirit janë bakteret koliform (E.Coli), streptokoku spp, staphylokokku, pseudomonas spp, klebsiella etj.

Faktorë të tjerë

Faktorë të tjerë që nxisin mastitin janë sëmundjet e përgjithshme si mbetja e placentës, inflamacioni i mitrës, problemet e stomakut dhe të sistemit intesinal dhe inflamacioni i thundrave.

Edhe forma e gjirit, si p.sh. gji i varur, rrit rrezikun e infeksionit dhe të dëmtimit. Pjesët rrethore të gjirit përbëjnë një rezervuar mikrobesh. Lia e gjirit dhe lythat janë shpesh shkaku që gjiri nuk milet mirë dhe kështu shkaktohet një infeksion. Çrregullime të metabolizmit dobësojnë gjendjen e përgjithshme dhe favorizojnë ndjeshmërinë ndaj mastitit.

Dëmet ekonomike

Krahas çrregullimeve të pjellorisë, mastiti është nga pikëpamja ekonomike sëmundja më e rëndësishme e bagëtisë. Inflamacioni i gjirit të lopës i shkakton fermerëve të qumështit në Austri 60 milion Euro humbje. Këto humbje financiare pasqyrohen në uljen e prodhimit të qumështit, ndërprerjen e furnizimit të qumështit, shpenzimet për trajtimin, si dhe uljen e jetëgjatësisë.

Mastiti subklinik

Mastiti subklinik haset më shpesh se mastiti klinik dhe është problemi i vërtetë i ndërlikimit të sëmundjes. Krahas humbjeve që shkaktohen drejtpërdrejtë nga ulja e prodhimit të qumështit duhet të llogariten dhe humbjet që shkaktohen nga rënia e cilësisë së qumështit. Rënia e cilësisë së qumështit shkaktohet nga ndryshimi i përbërësve të qumështit (përmbajtja e yndyrës, % e lëndës së thatë pa yndyrë, kazeinë, laktozë, minerale). Këto ndryshime në përbërjen e qumështit të papërpunuar sjellin gjithashtu vështirësi në përpunimin e qumështit si dhe në ndryshimin e shijes dhe qëndrueshmërisë së qumështit. Qumështi i marrë nga lopa e prekur nga mastiti subklinik ka një përmbajtje të lartë të qelizave somatike dhe rezulton në uljen e të ardhurave nga qumështi.

Mastiti klinik

Mastiti klinik çon në dëme të konsiderueshme ekonomike.

- Ndërprerja e përkohshme ose ndërprerja e plotë e prodhimit të qumështit.
- Ndërprerja e furnizimit me qumësht gjatë sëmundjes (koha e pritjes pas trajtimit)
- Kostot e trajtimit
- Reduktimin e kohës së shfrytëzimit
- Kohë pune shtesë

Kosto prodhimi vazhdimisht në rritje, rënia e çmimeve të prodhuesve ose kostot e qumështit i shtyjnë fermerët të gjejnë mënyra të tjera për minimizimin e shpenzimeve. Një metodë e re për

trajtimin e mastitit është nëpërmjet hemeopatisë. Kusht për të zbatuar hemeopatinë është gjetja e një veterineri me njohuri të mira të kësaj metode, ose edhe rastet kur njohuritë përvetsohen nga vetë fermeri.

Profilaksia e mastitit

- **Prova e mjeljes paraprake** - prishja e qumështit ose gjurmët e gjakut mund të dallohen lehtë
- **Testi Schalm** - Testimi kryhet para mjeljes, ndryshimet në përmbajtjen e qelizave somatike zbulohen menjëherë [-,+ , ++, +++]
- **Peceta njëpërdorimshme** - përdoren për pastrim
- **Desinfektimi i gjirit nëpërmjet shpëlarjes** - përdoren detergjentët e duhur
- **Pajisje mjelëse** - kalibrim i përvitshëm
- **Kontrollet laboratorike** - kryhen te kafshët me probleme për identifikimin e shkakut.
- **Në rast se shfaqen probleme të tufës** - duhet të përfshihen veterineri dhe shërbimi veterinar

Medikamente të rëndësishme për inflamacionin akut të gjirit

Reagimet e para të organizmit gjatë trajtimit janë të ngjashme me simptomat e sëmundjes:

1. Aconitum napellus

- ndodh papritmas, akute, shfaqet fuqishëm me temperaturë e lartë
- pasojë e të ftohtit të thatë dhe erës së ftohtë
- etje e madhe
- gjinj të ënjtur, me dhimbje, qumështi nuk ka ndryshuar ende.
- përkeqësim i gjëndjes nesë ka erë dhe në mesnatë
- përmirësimi ndodh në ajër të pastër

2. Belladonna

- Inflamacion akut i rëndë, më shumë i lokalizuar
- Shfaqen dhimbje të shpejta periodike
- Pasojë e të ftoftit dhe qarkullimit të ajrit të ftohtë
- Gjëndër qumështi e ënjtur, e nxehtë dhe me dhimbje

- Përkeqësim nga lëvizja dhe prekje

3. Bryonia

- Gjëndra qumështore shumë e fortë, zona është shumë e ndjeshme gjatë prekjes
- Shtypja konsiderohet e këndshme
- Kafshët shmangin çdo lëvizje
- Sekretionet ngjitëse, të pakëta
- Përmirësim nëpërmjet shtypjes, të ftohtit dhe qetësisë

4. Phytolacca

- Gjëndrat e gjirit të forta, të enjtura, të nxehta, shumë e dhimbshme
- Enjtje e gjithë gjendrës
- Qumështi ndryshon shumë
- Preparat i rëndësishëm për mastitin

5. Apis

- Enjtje e gjirit
- Shumë i ndjeshëm ndaj prekjes dhe shtypjes
- Ndjeshmëri e lartë ndaj dhimbjeve
- Sekretionet me njolla, qelbëzuese

6. Lachesis

- Sëmundje akute infektive me çrregullime të përgjithshme të rënda
- Pjesa e sëmurë shumë e ndjeshme ndaj prekjes dhe shtypjes
- Ngjyra e lëkurës bëhet blu
- Sekretionet qelbëzuese me gjak

7. Asa foetida

- Dhimbje e fortë dhe ndjeshmëri e lartë ndaj prekjes
- Lëkura nuk është e skuqur
- Sekretione që mbajnë erë
- Qumështi ndërpritet
- Gjijnjtë janë pak të enjtur

Medikamente të rëndësishëm për inflamacionin kronik të gjirit

Squfuri

- Është ilaç i rëndësishëm për problemet metabolike dhe shpesh për inflamacionet e gjirit që shkaktohen prej tyre.
- Përdoret si një reagent, nëse një ilaç i zgjedhur nuk jep efekt, ose nëse nuk shfaqen simptomat.

Homeopatia - mjekësia alternative

“Homeopati” vjen nga greqishtja dhe do të thotë “vuajtje të ngjashme” (homios=ngjashme, patos= vuajtje, vuajtje të ngjashme). Një terapi mbi 200 vjeçare që shëron sëmundje kronike dhe akute në mënyrë natyrale.

Homeopatia bazohet në përdorimin e dozave të vogla të tretura të substancave mjekësore, shumë herë më natyrale, për të aktivizuar mbrojtjen e vet trupit tonë, pra imunitetin dhe kështu arrihet përmirësimi ose shërimi i sëmundjes. Trajtimi bëhet me produkte kryesisht me përmbajtje bimore, minerale dhe shtazore. Ngjashmëria është parimi bazë i homeopatisë: “e njëjta kuron të njëjtën”. Përgatitjet homeopatike bëhen nga substanca ose produkte të quajtura “materiale fillestare” sipas procedurës së prodhimit homeopatik.

Nosoden

Nosodet janë substancë hemeopatike të përfituara nga indet apo organet e sëmura, të cilat duhet të përcaktohen vetëm nga veterineri. Ato duhet të përmirësojnë gjendjen shëndetsore, nëse mjekimet e përdorura nuk japin përmirësim. Në punën time, me anë të nosodeve kam mundur të mbaj në gjendje të mirë shumë bagëti.

Streptococcus viridans-Nosode: përmbajtja e qelizave rritet shumë

Streptococcus haemolyticus- Nosode: përmbajtja e qelizave rritet shumë

Streptococcus aureus-hacmolyticus: përmbajtja e qelizave rritet shumë

Sipas mjekësisë kafshët, të cilat janë të infektuara me streptococcus ose straphylococc, duhet të skartohen.

Klebsiella-Nosode: Infeksioni me klebsiella haset gjithmonë e më shpesh në punën time, nosodet mund të ndihmojë shumë mirë në këto raste.

Farmacit veterinarë

Së fundmi duhet të theksohet, se edhe në rastin e mjekimeve hemeopatike duhet të respektohen rregullat ligjore.

Kjo do të thotë që vetëm ilaçet e rekomanduara nga mjeku duhet të vihen në dispozicion. Këto ilaçe duhet të jenë të pajisura me emrin e veterinerit, emrin e ilaçit hemeopatik, dozën e përdorimit dhe afatin e përdorimit.

Higjiena e qumështit dhe shëndeti i gjirit - Përmbajtja e dëshiruar e qumështit

Niveli i gjirit të shëndetshëm tregohet me anë të numrit të qelizave somatike. Ajo kontrollohet me ndihmën e testit të Schalm (CMT-test). Nga çdo thithë e gjirit merret një sasi qumështi, vendoset në një provëz dhe përzihet me reagent. Gjatë përzierjes duhet që masa e ngjyrosur të mbetet homogjene, nuk duhet të ketë vijëzime.



Kur faza e laktacionit është drejt përfundimit, numri i qelizave të vdekura të gjirit rritet gjithmonë, por megjithatë nuk duhet të kalojë mbi 250.000 qeliza për çdo ml. qumësht. Në të kundërt ekziston rreziku që lopa të preket nga mastiti dhe inflamacioni i gjirit. Siç është përmendur tashmë, vetëm gjiri i shëndetshëm duhet të kalojë në periudhën e tharjes! Gjiri i sëmurë duhet të trajtohet para tharjes nga veterineri.

Numri i lartë i qelizave somatike çon në reduktimin e rendimentit të qumështit, sepse vdesin pikërisht qelizat e gjirit dhe kështu zvogëlohet niveli i prodhimit të qumështit në gji.

Gjatë procesit të mjeljes me makinë mjelëse duhet që lopët me gjinj të e sëmure duhet të mjelen gjithmonë në fund, kështu nuk transmetohen sëmundjet. Mbi të gjitha duhet që pjesa e kontaktit me gjirin te makina mjelëse të pastrohet dhe të dezinfektohet mirë.

Pecetat që përdoren për pastrim duhet të zëvendësohen me letrat për pastrimin e gjirit dhe duhet të përdoren vetëm tek një lopë, në të kundërt do të ekzistonte rreziku i trasmetimit të sëmundjes me anë të pecetës.

Numri i baktereve- tregues për higjenën e mjeljes

Kudo në stallë janë të pranishme baktere dhe mikrobe. Për këtë arsye është pastrim i plotë i gjirit shumë i rëndësishëm. Mikrobet shkaktojnë shumë shpejtë prishjen e qumështit.

Prandaj është e rëndësishme që para mjeljes të PASTROHEN MIRË duart, enët e qumështit, gjiri dhe makinat mjelëse!

Rrjedhjet e para të qumështit me përmbajtje të lartë të mikrobeve duhet të milen në një enë të veçantë që përmban një sitë errët dhe në këtë mënyrë mund të dallohen shumë lehtë dhe mirë ndryshimet e qumështit.

Më vonë të pastrohet dhe njëherë gjiri dhe gypat mjelës që vendosen në gji. Me pastrimin e gjirit bëhet dhe përgatitja për procesin e mjeljes.

Pasi kemi mbaruar punë me pastrimin fillohet me mjeljen. Gjiri duhet të milet shpejtë, sepse shpërndarja e qumështit mbi hormonin Oxytocin është efektive vetëm për një kohë të kufizuar.

Është e rëndësishme të vëzhgohet funksionimi i duhur i makinës mjelëse. Makina mjelëse e përbërë nga: kupat thithëse, gominat thithëse, tubacionet e sistemit mjelës, pompa e vakumit, filtri, pulsatori, tubi i ajrit, duhet të testohet dhe t'i bëhen rregullisht shërbimet.

Para së gjithash pastrimi është shumë i rëndësishëm! 4 Faktorë përcaktojnë cilësinë e pastrimit:

- Temperatura e ujit
- Detergjentët që përdoret për pastrim
- Mekanika e pastrimit
- Kohëzgjatja e pastrimit

Pastaj qumështi duhet të ftohet menjëherë! Temperatura duhet të jetë 4-5°C.

Klasifikimi i cilësisë së qumështit në Austri bazohet në dy parametra:

1. Në numrin e baktereve:

- Klasa "S": nën 50.000 ngarkesë mikrobike/ml
- Cilësi e parë: deri 100.000 ngarkesë mikrobike
- Cilësi e dytë: deri 200.000 ngarkesë mikrobike
- Cilësi e tretë: deri 400.000 ngarkesë mikrobike.

Kur tejkalohej kjo shifër nuk lejohet përpunimi i qumështit.

2. Në numrin e qelizave somatike: cilësi e parë nën 250.000 qeliza somatike. Kur tejkalohej kjo shifër përbën rrezik për mastitin.